



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 99, datë 31.05.2021

**PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ AGJENTËVE NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 198, pika 1 dhe 199, pika 6, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të nenit 38, pika 2, të Ligjit nr. 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në pikën 6, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, agjentit në sigurime z. Ylli Hoxha, i pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë 3-mujore.**
- 2. Bazuar në pikën 6, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014, agjentit në sigurime zj. Makbule Hoxha, i pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë 3-mujore.**
- 3. Bazuar në nenin 198, të Ligjit nr. 52/2014, shoqëria e sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., të marrë masa për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me përgjegjësinë e saj për veprimet e agjentëve në sigurime.**
- 4. Ngarkohen Departamentet përkatëse, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**